



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 185 Prot.

Tiranë, më datë 26.05.2023

VENDIM
Nr. 298, datë 26.05.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 26.05.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit Paraprak të gërmimit arkeologjik të shpëtimit të strukturave të “*Termës së periudhës romake, fshati Rrasë, Belsh*”, në Njësinë Administrative Rrasë, Bashkia Belsh, realizuar nga IKTK/DSHA në bashkëpunim me Departamentin e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, Fakulteti i Histori – Filologjisë në Universitetin e Tiranës;
2. IKTK të vijojë me hartimin e projektit për restaurimin e strukturave të “*Termës së periudhës romake, fshati Rrasë, Belsh*”, në bashkëpunim me DRTK Korçë dhe me mbështetjen e Bashkisë Belsh, si dhe përgatitjen e dosjes për shpalljen e interesit kulturor për objektin e zbuluar;
3. Në vijim të raportit paraprak të gërmimeve të realizohen:
 - a. Tre sondazhe arkeologjike përreth zonës ku janë zbuluar strukturat e termës së periudhës romake, me qëllim gjurmimin e vijueshmërisë së tyre;
 - b. Dy sondazhe arkeologjike në vendbanimin e identifikuar nga DSHA në lagjen e re të fshatit Trojas (lagja Mema), ku janë konstatuar gjurmët e mundshme të një *vila rustica*;
 - c. Një sondazh arkeologjik në zonën ku është identifikuar “*Bazilika e Trojasit*” në vitet 80-të, me qëllim verifikimin e gjurmëve të mundshme saj;
4. Në kuadër të plotësimit të hartës arkeologjike të zonës së Belshit, të vijohet me vrojtimin sipërfaqësor të pikave potenciale arkeologjike në zonën e fshatit Rrasë, Qafëshkallë dhe Trojas;
5. Rezultatet e sondazheve arkeologjike dhe vrojtimi sipërfaqësor në pikat potenciale, të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

7. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

KRYETAR

Elva MARGARITI

